



**Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës,**  
Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat,  
i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, nxjerr:

## **VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 01/2022**

### **PËR**

## **PROCEDURAT E TRASHËGIMISË LIGJORE TË BIZNESIT INDIVIDUAL PAS VDEKJES SË PRONARIT**

### **QËLLIMI**

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është që të sqaroj procedurat nga aspekti tatimor, lidhur me trashëgiminë e Biznesit Individual pas vdekjes së pronarit.

### **FUSHËVEPRIMI**

Ky Vendim Shpjegues Publik ju dedikohet të gjithë tatimpaguesve të cilët kanë statusin e personit fizik afarist (Biznes Individual), si dhe të gjithë zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës, të cilët angazhohen në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve, inspektime dhe kryerjen e kontrollave tatimore.

### **BAZA LIGJORE**

- Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, neni 6, paragrafi 6;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2015 për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;
- Ligji Nr.05/L-028 për Tatimin në të Ardhura Personale, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14;

## PROCEDURAT PËR TRASHIGIMINË LIGJORE TË BIZNESIT INDIVIDUAL PAS VDEKJES SË PRONARIT

Për qëllime tatimore trajtimi i rasteve të trashëgimisë ligjore/juridike të biznesit me rastin e vdekjes së pronarit në një apo më tepër trashëgimtar ligjor, është siç vijon:

1. Paragrafi 6 i nenit 6, të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH (tani e tutje Ligji për TVSH), përcakton që personi që vazhdon të zhvillojë aktivitet ekonomik të personit të tatueshëm i cili ka vdekur, trajtohet sikur të ketë qenë i regjistruar për qëllimet e TVSH-së, citojmë:

*“ATK-ja do të trajtoj sikur të ketë qenë i regjistruar për qëllimet e TVSH-së, çdo person që vazhdon të zhvillojë aktivitet ekonomik të personit të tatueshëm i cili ka vdekur, bankrotuar apo nuk është në gjendje të zhvillojë aktivitet ekonomik, nga data në të cilën personi i tatueshëm ka vdekur, bankrotuar apo nuk është në gjendje të zhvillojë aktivitet ekonomik, derisa personi tjetër të regjistrohet.”.*

2. Nënparagrafi 1.2 i paragrafit 1 të nenit 23 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2015, përcakton dallimin në mes të transferit të biznesit dhe trashëgimisë ligjore të biznesit, si dhe mënyrën e trashëgimisë juridike ligjore, citojmë:

*“Në përgjithësi transferi i biznesit bazohet mbi një kontratë të noterizuar në mes të transferdhënësit dhe transfermarrësit. Një transferim i biznesit bazuar në trashëgimi juridike, të tilla si testamentet, kontratat e trashëgimisë dhe trashëgimia Ligjore në rast të vdekjes së personit të tatueshëm që ndodhin jashtë fushëveprimit të Ligjit për TVSH, sipas nenit 13 të Ligjit nuk janë të aplikueshme për këto raste.”.*

3. Bartja e të drejtave pronësore nga personi i tatueshëm në një apo më tepër trashëgimtarë me rastin e vazhdimit të aktivitetit ekonomik nuk konsiderohet furnizim i mallrave dhe nuk është furnizim i tatueshëm. Kjo do të thotë se nuk është objekt i tatuarjes sipas nenit 3 të Ligjit për TVSH, sepse mungon furnizimi i mallrave, konsiderata dhe veprimi si person i tatueshëm. Në rastet e tilla asetet e trashëguara duhet të përdoren për aktivitetin ekonomik të trashëgimtarit ligjor/juridik dhe duhet synuar për të vazhduar biznesin.
4. Mbajtja e mallrave për qëllime jobiznesore pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik ose pas ç’regjistrimit të biznesit të të ndjerit (person i tatueshëm), ku TVSH për ato mallra ka qenë plotësisht apo pjesërisht e zbritshme, duhet të trajtohet si furnizim i mallrave për konsideratë sipas nenit 12.3 të Ligjit për TVSH, citojmë:

*“Me përjashtim të rasteve të referuara në nenin 13 të këtij ligji, mbajtja e mallrave nga personi i tatueshëm, ose nga pasardhësi i tij, kur ai ka pushuar së zhvilluari aktivitetin e tij ekonomik apo ka ndërprerë regjistrimin, ku TVSH-ja në ato mallra bëhet plotësisht ose pjesërisht e zbritshme me përvetësimin e tyre ose me shfrytëzimin e tyre në pajtueshmëri*

*me paragrafin 1, të këtij neni, gjithashtu konsiderohen si furnizime të mallrave për konsideratë.”.*

Kjo do të thotë, nëse trashëgimtari i biznesit, asetet e trashëguara i përdorë për qëllime private dhe jo për qëllime biznesore, konsiderohet si furnizim i mallrave për konsideratë dhe janë furnizime të tatueshme.

5. Trashëgimtarët e biznesit, janë përgjegjës për borxhet që ngarkojnë trashëgiminë, përfshirë edhe përgjegjësinë për detyrimet tatimore të trashëgimlënësit në proporcion me pjesën e tyre që e kanë trashëguar në përputhje me Ligjin përkatës mbi Trashëgiminë në Kosovë.
6. Në rastin e vdekjes, si dhe në rastin e humbjes së aftësisë afariste të ndërmarrësit (përmes Vendimit nga Gjykata kompetente), trashëgimtari, i cili me këtë rast si person fizik ka aftësi veprimi si afarist, mund të vazhdoj kryerjen e aktiviteteve ekonomike nëse është i pajisur me vendimin nga Gjykata kompetente mbi trashëgiminë dhe marrëveshjen në mes të tyre (trashëgimtarëve) të vërtetuar nga Noteri, për vazhdimin e kryerjes së aktivitetit ekonomik, si përfaqësues ligjor i pasurisë të cilën e nënshkruajnë të gjithë trashëgimtarët.
7. Trashëgimtari si përfaqësues ligjor i pasurisë, është i obliguar që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga data e vdekjes së pronarit, të njoftoj Administratën Tatimore të Kosovës, për vazhdimin e aktivitetit ekonomik.
8. Në rast të vdekjes së pronarit, detyrimet tatimore të mbetura do të transferohen tek trashëgimtarët ligjor/juridik. Detyrimet tatimore do të transferohen vetëm nëse kanë rrjedhur para vdekjes së pronarit.
9. Për periudhën nga momenti i vdekjes së pronarit deri tek pranimi i trashëgimisë me detyrime, përgjegjës për kryerjen e detyrimeve tatimore është përfaqësuesi ligjor i pasurisë.
10. Nëse plotësohen të gjitha kushtet e parapara ligjore për këto raste të trashëgimisë ligjore të biznesit, Drejtoria Operative Rajonale përkatëse / Departamenti i Tatimpaguesve të Mëdhenj do të ç’regjistroj dhe anuloj të gjitha dokumentet që i ka lëshuar për këtë person tanimë të ndjerë, si:
  - Certifikatën e TVSH-së,
  - Certifikatën e Numrit. Fiskal (nëse ka), etj.Këto dokumente do të tërhiqen dhe konsiderohen të pavlefshme nga data e aprovimit të kërkesës për trashëgimi ligjore të biznesit.
11. Trashëgimtari ligjor/juridik i biznesit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e nxjerrjes së Vendimit të trashëgimisë nga Gjykata kompetente, duhet të njoftoj në formë të shkruar Drejtorinë Operative Rajonale përkatëse / Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, për trashëgiminë ligjore të biznesit.

Njoftimi duhet të përmbajë informatat bazike, si në vijim:

- Datën e njoftimit;
- Bazën ligjore tatimore të përshkruar për këto raste;
- Emrat e bizneseve, emri dhe mbiemri i trashëgimlënësit dhe trashëgimtarit;
- Numrat Unik Identifikues të të dy bizneseve;
- Numrat e certifikatave të TVSH si persona të tatueshëm (trashëgimlënësit dhe trashëgimtarit);
- Certifikatën e vdekjes së trashëgimlënësit;
- Llojin e trashëgimisë biznese: i plotë apo i pjesshëm (kur janë funksionale njësitë e pavarura biznese nga ndërmarrja e përbërë);
- Kopjen e vërtetuar të vendimit të organit kompetent mbi trashëgiminë ligjore /juridike;
- Veprimtarinë afariste që ushtrohet me ato mjete biznese të trashëguara;
- Vlerën e mallrave/aseteve të trashëguara në total dhe sipas përfituesve (të bashkëngjitet specifikacioni i mallrave/aseteve);
- Periudhën tatimore të TVSH kur bëhet procedimi i trashëgimisë ligjore;
- Balancën kreditore të mbetur në këtë periudhë tatimore;
- Borxhet (detyrimet, obligimet) tatimore në total;
- Nënshkrimin e trashëgimtarëve apo i përfaqësuesit në bazë të vendimit të organit kompetent.

12. Të gjitha procedurat e lartshënuara aplikohen edhe për rastet kur Biznesi Individual nuk është deklarues i TVSH.

## HYRJA NË FUQI

Ky Vendim Shpjegues Publik hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës.

Data: 24 / 01 / 2022



Ilir Murtezaj

Drejtor i Përgjithshëm i ATK